



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
(Janar-Mars 2009)

Prishtinë, Prill 2009

HYRJE

Departamenti i Vetëqeverisjes Lokale (DVL), në bazë të mandatit që ka, monitoron në vazhdimësi aktivitetin e Komunave të Republikës së Kosovës dhe harton raportet periodike.

Ky Raport fokusohet në paraqitjen e gjendjes reale të Kuvendeve të Komunave për periudhën janar-mars 2009. Në të paraqiten veprimet që kanë ndërmarrë komunat në lidhje me zbatimin e legjislacionit nga fusha e qeverisjes lokale, me theks të veçantë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Raporti është rezultat i analizës së të dhënave që kanë deponuar Komunat, sipas pyetësorëve të përgatitur nga MAPL, monitorimit të seancave të Kuvendeve të Komunave nga ekipet e monitorimit të Departamentit për Vetëqeverisje Lokale dhe evidencës së veprimeve të Komunave në drejtim të implementimit të legjislacionit, që ka në dispozicion MAPL, sipas gjendjes së evidentuar në terren.

Konkretisht, raporti përfshin numrin e seancave të Kuvendeve të Komunave për tremujorin e parë të këtij viti, funksionimi i komiteteve obligative, funksionimi i komiteteve të tjera, mbajtja e tubimeve publike me qytetarët, numri i kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare, rregulloret e miratuara gjatë kësaj periudhe, vendimet e miratuara gjatë këtij tre mujori etj.

**AKTIVITETET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE PËR TREMUJORIN E PARË TË
VITIT 2009**

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave dhe komiteteve

Sfondi Ligjor - Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendet e Komunave mbledhen në seanca të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Sipas nenit 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës.

Mbledhjet parimisht thirren nga Kryesuesi i Komunës, së paku 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së rregullt dhe 3 ditë pune para mbajtjes së takimit të jashtëzakonshëm. Gati në të gjitha komunat materialet në lidhje me pikat e rendit të ditës në mbledhje, iu dërgohen në afat anëtarëve të Kuvendit.


Vlerësimi i gjendjes aktuale në Komuna.- Në shumicën e Komunave, Kuvendet e Komunave janë funksionale dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre normalisht.

Konkretisht, gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 Kuvendet e Komunave kanë mbajtur mbledhje të rregullta si në vijim:

Nga 3 (tre) mbledhje në Shtime, Klinë, Suharekë, Ferizaj, Gjilan, Mamushë, Hani të Elezit, Kaçanik, Pejë, Deçan, Skenderaj, Glogoc, Novobërdë, Junik, Gjakovë, Vushtrri, Dragash, Fushë-Kosovë dhe Kamenicë; nga 2 (dy) mbledhje: Prishtina, Mitrovica, Malisheva, Lipjani, Prizreni, Vitia, Podujeva, Rahoveci dhe Istogu, ndërsa Kuvendi i Komunës së Obiliqit ka mbajtur 1 (një) mbledhje .

Marrë në total në tremujorin e parë të vitit 2009, kuvendet e komunave kanë mbajtur 41 mbledhje. Deri tani, përveç komunës së Obiliqit që ka mbajtur vetëm 1 mbledhje, komunat e tjera kanë mundësi që të realizojnë së paku 5 mbledhje të kuvendeve komunale për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, ashtu siç parashikohet me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Numri i Mbledhjeve të rregullta për tremujorin e parë të vitit 2009



Mbledhjet e Jashtëzakonshme

Takime të jashtëzakonshme kanë mbajtur këto komuna: Shtime dhe Mitrovica nga 2 takime; Istogu, Kaçaniku dhe Gjilani nga 1 takim, ndërsa komunat e tjera nuk kanë mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendeve të komunave gjatë tre-mujorit të parë të vitit 2009.

Mbledhjet e Komiteteve Obligative

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2009, Komitetet për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetet për Komunitete (KK) në komunat e Republikës së Kosovës kanë mbajtur mbledhjet si në vijim: Fushë Kosovë (KPF 2, KK 1), Ferizaj (KPF 2, KK 0), Rahovec (KPF 2, KK 0), Vushtrri (KPF 3, KK 3), Prishtinë (KPF 2, KK 4), Malishevë (KPF 3, KK 2), Suharekë (KPF 3, KK 2), Lipjan (KPF 3, KK 2), Kaçanik (KPF 3, KK 1), Deçan (KPF 3, KK 3), Klinë (KPF 3, KK 3), Glllogoc (KPF 3, KK 0), Obiliq (KPF 2, KK 0), Gjilan (KPF 2, KK 2), Istogu (KPF 3, KK 2), Junik (KPF 3, KK 1), Skënderaj (KPF 3, KK 3), Podujevë (KPF 2, KK 3), Hani i Elezit (KPF 4, KK 1), Viti (KPF 3, KK 0), Novobërdë (KPF 3, KK 0), Prizren (KPF 2, KK 2), Gjakovë (KPF 3, KK 3), Dragash (KPF 3, KK 3), Mitrovicë (KPF 2, KK 2), Peja (KPF 3, KK 3), Shtime (KPF 3, KK 3), Kamenicë (KPF 2, KK 2), Mamushë (KPF 1, KK 0).

Themelimi i Komiteteve të tjera

Sfondi Ligjor- Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, neni 51.2 ka paraparë që Kuvendi i Komunës të themelojë edhe Komitete të tjera, të cilat i konsideron të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre.

Komunat të cilat kanë themeluar Komitete të tjera janë: Obiliqi (5), Prishtina (7), Deçani (4), Skenderaj (5), Prizreni (8), Gjilani (7), Ferizaj (6), Vitia (5), Lipjani (4), Kamenica (5), Suhareka (1), Kaçaniku (4), Istogu (2), Klina (4), Mitrovica (5), Malisheva (5), Fushë Kosova (1).

Komitete, të cilat janë themeluar nga shumica e Komunave, janë: Komiteti për Arsim dhe Kulturë, Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Tarifa dhe Ngarkesa Kadastrale, Komiteti për Zhvillim Ekonomik etj.

Komiteti për Sigurinë e Komuniteteve

Sipas të dhënave të siguruara nga pyetësorët, Komiteti për Sigurinë e Komuniteteve është themeluar në këto komuna: Lipjan, Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Shtime, Dragash, Vushtrri, Gjakovë, Malishevë, Junik, Pejë, Prishtinë, Obiliq, Skenderaj, Novobërdë, Deçan, Podujevë dhe Klinë.

Tubimet Publike

Sfondi Ligjor.- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 68.1, ka paraparë mbajtjen e së paku dy tubimeve publike në vit (nga 1 në çdo gjashtë muaj) me qytetarët, për t'u informuar më për së afërmi me aktivitetet e komunës.

Vlerësimi i gjendjes aktuale.- Për periudhën e raportimit, komunat që kanë mbajtur takime publike janë: Kamenica, Lipjani, Prishtina, Novobërda, Hani i Elezit, Klina.

Miratimi i Rregullores të punës së Kuvendeve të Komunave

Sfondi ligjor.- Neni 12 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale parasheh cilat akte mund t'i miratojë Kuvendi i Komunës, brenda fushës së kompetencave të veta.

Vlerësimi i gjendjes aktuale.- Gjatë tremujorit të parë komunat të cilat kanë miratuar rregullore janë: Glllogoc (1), Gjakovë (1), Peja (1), Novobërdë (3), Suharekë (2), Skenderaj (2), Ferizaj (3), Istogu(3), Vushtrri (2), Deçan (1), Prishtinë (3), Rahovec (2), Mitrovica (1), Kamenica(3), Malisheva(1), Dragashi(1), Vushtrria (2), Juniku(2).

Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale e kanë miratuar deri tani komunat: Hani i Elezit, Kaçaniku, Juniku, Vushtrria, Gjakova, Dragashi, Malisheva, Mitrovica, Fushë Kosova, Istogu, Klina, Peja, Obiliqi, Prishtina, Deçani, Skenderaj, Glllogoc, Novobërda, Gjilani, Ferizaj, Kamenica, Prizreni, Shtimja, Lipjani, Vitia.

Rregulloren për përdorimin e gjuhëve në përputhje me nenin 9.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 2.4 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve e kanë miratuar këto komuna: Istogu, Fushë Kosova, Klina, Peja, Obiliqi, Prishtina, Novobërda, Suhareka, Kamenica, Gjilani, Ferizaj.

Miratimi i Rregullores komunale për transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative

Rregulloren komunale për transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative e kanë miratuar këto komuna: Mamusha, Kaçaniku, Peja, Glllogoci, Novobërda, Lipjani, Ferizaj, Suhareka Shtime, Gjilan, Kamenicë, Dragashi dhe Juniku.

Kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare

Sipas të dhënave që ka në dispozicion MAPL-ja, gjatë tre mujorit të parë të vitit 2009 nuk ka pasur interesim të madh të qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare. Vetëm komunat e mëposhtme kanë pasur kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare: Viti (5), Kamenica(3), Gjilani (1), Glllogoci (1), Malisheva(1).

Kërkesat dhe peticionet drejtuar Kuvendit të Komunës

Komunat e Republikës së Kosovës që kanë pranuar kërkesa dhe peticione nga qytetarët janë: Klina, Obiliqi, Prishtina, Deçani, Glllogoci, Ferizaj, Gjilani, Kamenica, Vitia kanë pranuar kërkesa, ndërsa komunat Skenderaj, Vushtrri, Mitrovicë, Dragash, Novobërdë, Dragash, Mitrovicë kanë pranuar nga një peticion.

Konflikti i interesit të këshilltarëve komunal

Sfondi ligjor.- Neni 38.2 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale parasheh që çdo anëtar i Kuvendit Komunal duhet të shfaqë të gjitha konfliktet e interesit, që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve.

Komunat në të cilat këshilltarët kanë paraqitur konfliktin e interesit janë: Istogu, Peja, Prishtina, Novobërda, Gjakova, Juniku, Vushtrria, Mitrovica, Gjilani, Prizreni, Lipjani, Shtime.

Konflikti i interesit për Kryetarin

Sfondi ligjor.- Neni 59.3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale thekson se Kryetari i komunës duhet të paraqesë konfliktin e interesit menjëherë sapo të shfaqet një konflikt interesi.

Komunat në të cilat Kryetari ka paraqitur konfliktin e interesit janë: Gjilani, Kamenica, Lipjani, Prizreni, Gjakova, Juniku, Vushtrria, Mitrovica, Obiliqi, Peja, Prishtina, Deçani, Skenderaj, Novobërda, Rahoveci dhe Istogu.

Rastet kur Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete i paraqet Kuvendit për rishqyrtim aktet apo vendimet e Komunës.

Sfondi Ligjor.- Sipas nenit 55.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete i paraqet Kuvendit të Komunës për rishqyrtim aktet apo vendimet e Komunës. Gjatë periudhës tre-mujore të raportimit, në asnjë nga komunat e Republikës së Kosovës nuk ka pasur raste të tilla.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me komunat e tjera

Komunat e Republikës së Kosovës të cilat kanë lidhur Marrëveshje të bashkëpunimit me komunat e tjera janë: Vitia (një marrëveshje në fushën e infrastrukturës) dhe Gjakova (dy marrëveshje).

Marrëveshjet e Komunës me fshatra, vendbanime apo lagje

Sfondi Ligjor.- Sipas nenit 34.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, çdo komunë mund të bëjë marrëveshje me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane brenda territorit të saj, për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave për të gjithë qytetarët e komunës.

Komunat të cilat kanë lidhur Marrëveshje të tilla janë: Vushtrria (3), Ferizaj (4), Gjilani(1), Klina (1), Prishtina (1), Deçani(1).

Miratimi i Vendimeve

Komunat të cilat kanë miratuar Vendime të Kuvendit të Komunës gjatë tre-mujorit të parë të vitit 2009 janë: Kaçaniku (10), Istogu (4), Klina (12), Hani Elezit (6), Mamusha (1), Rahoveci (11), Podujeva (4), Obiliqi (5), Prishtina (9), Skenderaj (10), Novobërda (10), Peja (14), Deçani (6), Glllogoci (7), Vushtrria (37), Mitrovica (27), Gjakova (15), Fushë Kosova (12), Malisheva (8), Juniku (7), Dragashi (5), Gjilani (32), Ferizaj (21), Shtime (17), Prizreni(9), Vitia (7), Suhareka (7), dhe Lipjani (7) .

Raport për zbatimin e Ligjeve nga Fushëveprimi i MAPL-së

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
1.	Ligji Për Vetëqeverisje Lokale	Nr. 03/L-040	20.02.2008	(a) i plotë	<p>- Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/8 Për marrëveshjet e bashkëpunimit të komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane;</p> <p>- Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/9 Për transparencë në komuna;</p> <p>- Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/10 Për organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në komuna;</p> <p>- Udhëzimi Administrativ 2009/1 për Procedurën e zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;</p> <p>- Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2008 Për Pagesën e stafit politik në komuna</p>	

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
					(Qeverisë)	
2.	Ligji për Barazi Gjinore	Nr. 3004/02	19 shkurt 2004	(a) i plotë	- Udhëzim Administrativ Nr. 2005/08 Për caktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave të punës së zyrtarëve për barazi gjinore në komuna	

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
3.	Ligji Për Përdorimin e Gjuhëve	Nr. 02/L-37	27.07.2006	(b) i plotë	- Udhëzim Administrativ Nr. 2007/2 Për përcaktimin e procedurave për zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve	

Raport për zbatimin e Ligjeve nga Fushëveprimi i Qeverisjes Lokale - Komunave

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
1.	Ligji Për Vetëqeverisje Lokale	Nr. 03/L-040	20.02.2008	(b) i pjesërishtëm	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i Statutit të Komunës (28 komuna); 2. Miratimi i Rregullores së Punës; 3. Miratimi i rregullores për bashkëpunim të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane; 4. Miratimi i Rregullores komunale për transparencë 	

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjor (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
2.	Ligji për Barazi Gjinore	Nr. 3004/02	19 shkurt 2004	(a) i plotë	5. Hartimi i politikave për promovimin e barazisë gjinore në komuna.	
3.	Ligji Për Përdorimin e Gjuhëve	Nr. 02/L-37	27.07.2006	(b) i pjesërishtëm	6. Miratimi i Rregullores lokale për përdorimin e gjuhëve në komuna	

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
4.	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal	Nr. 03/L-049	13.03.2008	(b) i pjesërishtëm	7. Nxjerrja e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë afariste; 8. Nxjerrja e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, 9. Nxjerrja e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë së automjeteve motorike; 10. Nxjerrja e Rregullores për dhënien e lejeve për ndërtim në komuna; 11. Nxjerrja e Rregullores për rregullat e trafikut dhe përcaktimi i gjobave.	
5.	Ligji për Transportin Krugor	2005/23	23.03.2005	(b) i pjesërishtëm	12. Nxjerrja e Rregullores për mënyrën e transportit të udhëtarëve	

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
6.	Ligji për Ujrat	2004/24	08.07.2004	(b) i pjesërishtëm	13. Nxjerrja e vendimit për shpalljen e zonave erozive	Mungesa e resurseve profesionale
7.	Ligji për Planifikimin Hapësinor	2003/14	03.07.2003	(b) i pjesërishtëm	14. Përgatitja e planit zhvillimor komunal; 15. Miratimi i Planit Urban Zhvillimor; 16. Miratimi i planit hapësinor	Mungesa e planit hapësinor të përgjithshëm

KONKLUZIONE:

Duke u bazuar në të dhënat që ka në dispozicion MAPL për periudhën e tremujorit të parë vitit 2009, mund të konkludojmë:

- *Komunat kanë mbajtur numër të mjaftueshëm të seancave të Kuvendeve. Mund të konstatohet se Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës janë funksionale, me përjashtim të komunave ku komuniteti serb është shumicë, të cilat nuk kanë bashkëpunim me institucionet e Kosovës.*
- *Komunat kanë miratuar rregullore komunale, të cilave iu është vlerësuar ligjshmëria nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;*
- *Në përgjithësi, Komunat kanë ndërmarrë aktivitete në lidhje me zbatimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.*
- *Shumica e Komunave kanë themeluar edhe komitete të tjera, përveç atyre obligative.*

REKOMANDIME:

- MAPL, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 12.2 pika b), rekomandon që Komunat të cilat nuk e kanë miratuar Rregulloren e punës, ta miratojnë atë sa më parë.
- Komunat duhet të zbatojnë nenin 43.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për t'i dërguar Ministrisë përgjegjëse për qeverisjen lokale materialet e mbledhjes, 7 ditë para mbajtjes së seancës së Kuvendit Komunal.

- Komunat duhet të dërgojnë rregullisht aktet juridike që miratojnë, në mënyrë që të vlerësohet ligjshmëria e tyre, sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.
- Në përputhje me kërkesën e MAPL-së, Kuvendet e Komunave të Vitisë, Kaçanikut dhe Mamushës të rishqyrtojnë vendimet e tyre.
- MAPL-ja, pas identifikimit të dispozitave ligjore që detyrojnë komunat të nxjerrin akte nënligjore komunale me qëllim zbatimin efikas të ligjeve konkrete, rekomandon që në një afat sa më të shkurtër të miratohen aktet nënligjore që i bashkëngjiten këtij raporti.

Prishtinë, 15 Prill 2009

*Departamenti për Vetëqeverisje Lokale
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*